



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dosturuar Priljezba / Priljezba Received / Delivery	17-01-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtetja Priljezba Appentia	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	408/2023		117



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1017/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1017/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.2419/2 të datës 14.10.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1017/2022 e datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi Nr.2419/2 i datës 14.10.2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe Vendimi me Nr.0702/2022 i datës 13.10.2022 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, që ankuesit të kompensojë të gjitha pagat e pa realizuara nga dita e shkarkimit me datë 14.10.2022 deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi, ndërsa Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë obligohet që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të emëroj ankuesin në një pozitë të mesme drejtuese apo profesionale në kuadër të Shërbimit Civil, të gjitha këto brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, më datë 14.11.2022 (pranuar përmes postes me datë 17.11.2022) përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7190/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1017/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.2419/2 të datës 14.10.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 29.11.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 07.12.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.12.2022 me Vendimin VK.nr.195/2022 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1017/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7190/2022, e regjistruar nën shenjen A.nr.1017/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.0702/2022 të datës 13.10.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.2419/2 të datës 14.10.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Shkresën e datës 14.10.2022; Shkresë me titull: Komentet e draft raportit të Auditimit nga ankuesi e datës 28.06.2020; Emailin e datës 22.11.2021, 23.11.2021, 2.11.2021 nga për Shkresën me titull: Kontrollimi mjekësor i Zjarrfikësve dhe testimi i pajisjeve mbrojtëse e datës 11.10.2021; Shkresën me titull: Verifikimi i aftësive fizike të Zjarrfikësve në NJPZSH e datës 06.10.2021; Shkresën me titull: Marrëveshje për kontroll mjekësor për zjarrfikës e datës 13.10.2021; Draft Raportin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të MPB për AME nëntor 2021; Zarkin e datës 14.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.11.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 07.12.2022; Vendimin e datës 02.09.2009 për emërimin e ankuesit në pozitën e Drejtorit të Menaxhimit të Emergjencave; Kontratën e Marrëdhënies së punës me Nr.1/2009 të datës 15.09.2009; Vendimin me Nr.9 të datës 14.09.2019 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave; Vendimin me Nr.05/66 të datës 14.02.2012 për emërimin e ankuesit Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhim Emergjent; Vendimin me Nr.107/2015 të datës 13.03.2015 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent; Vendimin me Nr.02/25 të datës 22.01.2018 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit; Raportin Final të Auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm e MPB për AME, nëntor 2021; Vendimin VK.nr.195/2022 të datës 27.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës veç e veç dhe gjitha se bashku konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës nga data 15.09.2009 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa i njëjti se fundi me datë 22.01.2018 është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit Emergjent, me mandat pesë (5) vjeçar, dhe atë nga data 22.01.2018 deri me datë 22.01.2023.

Ankuesi, me datë 13.10.2022 me Vendimin Nr.0702/2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme është suspenduar nga marrëdhënia e punës nën dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale, ndërsa me Vendimin Nr.2419/2 të datës 14.10.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është shkarkuar nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, me arsyetimin e njëjtë mbi të cilën edhe ishte suspenduar, gjegjësisht nën dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale që ndërlidhet me gjetjet e raporteve të auditimit. Rrjedhimisht, sipas aktit të kontestuar ankuesi është udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kundër Vendimit Nr.2419/2 të datës 14.10.2022, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe është nxjerr pas konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase i njëjti pretendon se ankuesi gëzon statusin e zyrtarit publikë në kuptim të Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil pa pasur asnjë procedurë siç përcaktohet me ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë, dhe Rregulloren në fuqi (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues. Po ashtu pala ankuese pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerr nga organi jo kompetent në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 52 të këtij ligji, ngase në rrethanat e rastit konkret kryeministri ka mbivendosur në raport me qeverinë kur dihet se ankuesi është emëruar nga kjo e fundit.

Ndërsa, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje referuar si DMZP) si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës qendrore, në përgjigjen e dhënë në ankesë me datë 06.12.2022 pretendon se Vendimi Nr.2419/2 i datës 14.10.2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës është i drejtë dhe i bazuar në ligj, kurse ankesa e ankuesit e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar është e pa bazuar dhe nuk e sjell në dyshim ligjshmërinë e Vendimit me Nr.2419/2 të datës 14.10.2022. Tutje, DMZP thekson se pretendimet e palës ankuese për shkelje esenciale të dispozitave të ligjit dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë të paqëndrueshme sepse me vendimin e kontestuar është vërtetuar në tërësi gjendja faktike dhe është zbatuar drejtë ligji material, dhe se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka mandat për të bërë vlerësimin dhe verifikimin e veprave penale, ndërsa duke ju referuar pretendimeve të palës ankuese se vlerësimi i veprave penale nuk është kompetencë as e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, kjo njësi po ashtu nuk e kundërshton një gjë të tillë, por vlerëson se Kryeministri ka mandat të dhënë në Ligj për të nxjerr vendim për largim nga puna, mbi bazën e dyshimit të bazuar se personi ka kryer vepër penale, duke ju referuar kështu nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent. Në përgjigjen e dhënë në ankesë po ashtu ky organ thekson se Kryeministri i Republikës së Kosovës, e as Ministri i Punëve të Brendshme

nuk kanë kualifikuar e as vlerësuar vepër penale, por mbi bazën e dyshimit të bazuar kanë respektuar detyrimin ligjor për marrjen e masave sipas Ligjit për AME-në.

DMZP, duke hedhur poshtë pretendimet e palës ankuese, ndonëse fillimisht pretendon se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka mandat për trajtimin e çështjes se ngritur, në fund të përgjigjes në mënyrë krejtësisht kundërthënës kërkon që të refuzohet ankesa e palës ankuese dhe të vërtetohet Vendimi Nr.2419/2 i datës 14.10.2022 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, duke ju referua dispozitave të nenit 9 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe nenit 22 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenit 2 paragrafi 3, dhe nenit 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstatoi se pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, kualifikohet si pozitë e kategorisë së nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, dhe si rrjedhojë ankuesi gëzon statusin e nëpunësit civil, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në nenin 101.2 të Kushtetutës si dhe nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka juridiksion të plotë për trajtimin e çështjes ankimore të parashtruar para saj.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese, konstatoi se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020 dhe se me dispozitat e nenit 32 paragrafi 3 të të njëjtit ligj përcaktohet se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, ndërsa me nenin 85 të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Rrjedhimisht, nga analizimi i Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Gjykata Kushtetuese duke vendosur lidhur me komentet e Policisë së Kosovës, të cilat për nga natyra juridike janë të ngjashme me objektin e çështjes, kishte sqaruar mjaftueshëm se ligji i kontestuar (*ligji për zyrtarët publikë*) sipas nenit 85 të tij në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil si dhe çdo dispozitë tjetër juridike, që është në kundërshtim me të, duke përfshirë edhe ligjet e veçanta. Ndërsa lidhur me pretendimin e Policisë së Kosovës se ligji i kontestuar cenon parimin e sigurisë juridike pasi nuk shfuqizon në mënyrë specifike Ligjin për Policinë e Kosovës lidhur me dispozitat që rregullojnë marrëdhënien e punës së stafit administrativ, duke iu referuar kështu Aktgjykimin në rastin nr.KO97/12 të datës 13 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar se rrethanat e këtij rasti dallojnë nga rrethanat e Ligjit të kontestuar (*ligji për zyrtarët publikë*) pasi, Ligji i kontestuar në nenin 85 në mënyrë të qartë shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të duke rregulluar marrëdhënien e punës për të gjithë zyrtarët publikë me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pretendimi i Policisë së Kosovës lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr.KO97/12 nuk është i bazuar (*shih* Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, paragrafi 192-198).



Andaj, për sa me sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë shfuqizuar dispozitat e ligjit të veçantë, në këtë rast dispozitat e Ligjit Nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me të cilat është përcaktuar procedura dhe mënyra e emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, ngase kjo pozitë e punës klasifikohet si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese në Shërbimin Civil, dhe si e tillë i nënshtrohet fushëveprimit të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ligj rregullon procedurën dhe mënyrën e emërimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës të nëpunësve civil, duke përfshi këtu edhe ankuesin, konstatim ky i cili gjen mbështetje edhe nga vetë përgjigjja në ankesë e DMZP-së, ngase kjo njësi është përgjigjur në ankesë në kuadër të autorizimeve që burojnë nga dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, në frymën e këtij standardi kishte vendosur edhe me rasatin e trajtimit të ankesës A.nr.308/2020 të datës 19.10.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore të palës ankuese se vendimi i kontestuar për shkarkimin e ankuesit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e ligjit përkatës, gjegjësisht dispozitat e nenit 59 me të cilat rregullohet mënyrën e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, duke përcaktuar se: *1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, përfundon si ne vijim; 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirim nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj, dhe si rrjedhojë në referencë të këtyre dispozitave ligjore dhe nga analizimi i aktit të kontestuar si dhe shkresave tjera të lëndës, rrjedhë se ankuesi është shkarkuar nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent pa u përmbush asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 60, 61 dhe 62 ndërlidhur me nenin 59 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, ngase nga shkresa e shqyrtuara të lëndës, ashtu sikurse edhe nga shqyrtimi i aktit të kontestuar është konstatuar se ndaj ankuesit për shkak të shkeljeve të pretenduara nuk është zhvilluar procedurë disiplinore dhe për pasojë nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore për largim nga Shërbimi Civil, ashtu sikurse ndaj të njëjtit nuk është ngritur aktakuzë mbi dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale dhe rrjedhimisht nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerje të veprës penale.*

Kolegji i Këshillit thekson faktin se mos realizimi i objektivave të përcaktuara dhe sjellja jo profesionale e nëpunësit civil përben shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, mirëpo një gjë e tillë duhet të vërtetohet paraprakisht nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve të punës dhe nëse për dy vite radhazi nëpunësi civil merr vlerësim jo të kënaqshëm, atëherë përmbushet kushti ligjor për lirim nga Shërbimi Civil në kuptim të nenit 61 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu, shkelja e detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore gjatë ushtrimit të detyrave të punës përbejnë shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit civil, përkatësisht largimin nga Shërbimi Civil, siç përcaktohet me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo Kolegji i Këshillit vlerëson se shkelja e detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore nga nëpunësit civil duhet të vërtetohen

nga organi kompetent, në këtë rast nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, dhe vetëm pas konstatimit të shkeljeve nga organi përkatës dhe të cila korrespondojnë me masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil", konsiderohet se është përmbush kushti ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.

Andaj, duke qenë se ankuesi nuk posedon dy vlerësime jo të kënaqshme për dy vite radhazi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si dhe ndaj të njëjtit nuk është zhvilluar procedurë disiplinore lidhur me shkeljet e pretenduara në vendimin e kontestuar, Kolegji i Këshillit vlerëson se nuk është përmbush kushti ligjor për lirim të ankuesit nga Shërbimi Civil për shkak të mos realizimit të objektivave të përcaktuara dhe sjelljes jo profesionale, ashtu sikurse nuk është plotësuar kushti ligjor për lirim të ankuesit nga pozita për shkak të shkeljes së detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore në kuptim të nenit 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 dhe nenin 61 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i drejtë dhe i bazuar.

Kolegji i Këshillit po ashtu thekson faktin se dënimi i nëpunësit civil për kryerjen e një veprë penale me dashje apo për çfarëdo veprë penale për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër, përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, mirëpo për tu plotësuar ky kusht ligjor duhet të ekzistoj një vendim i formës së prerë lidhur me dënimin e shqiptuar nga një gjykatë kompetente. Rrjedhimisht, nga analizimi i aktit të kontestuar si dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi nuk posedon një aktakuzë të ngritur mbi dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale, ashtu sikurse nuk ka në fuqi një vendim të formës së prerë për kryerje të veprës penale, dhe se organi përkatës i punësimit me asnjë provë nuk ka arritur të argumentoj të kundërtën e këtij konstatimi, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit nuk është përmbushur kushti ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit për shkak të veprës penale siç përcaktohet me nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe për pasojë pretendimi ankimor për shkelje të ligjit material është i drejtë dhe i bazuar, ndërsa akti i kontestuar është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se vendimi i kontestuar është nxjerr përmes shkeljeve procedurale, Kolegji i Këshillit nisur nga fakti se shkarkimi i ankuesit është bërë mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerje të veprës penale, si dhe duke marr për bazë konstatimin e dhënë në arsyetim të këtij vendimi se ankuesi gëzon statusin e nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, vlerëson se konstatimi i plotësimit të kushteve ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të kryerjes së veprës penale është në mandatin e ministrisë përgjegjëse për administratë publikë siç përcaktohet me nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 ndërlidhur me paragrafin 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit vendimi për shkarkimin e ankuesit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent është nxjerr në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe se pretendimi ankimor i palës ankuese është i drejtë dhe i bazuar, ndërsa akti i kontestuar si i tillë është i paligjshëm edhe në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, meqenëse akti i kontestuar është nxjerr përmes shkeljeve procedurale dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për aprovimin e ankesës A.nr.1017/2022 të datës 17.11.2022, anulimin e Vendimit Nr.2419/2 të datës 14.10.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si dhe Vendimit Nr.0702/2022 të datës 13.10.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi bazën e të cilit ishte nxjerr vendimi i kontestuar, duke obliguar Ministrinë e Punëve të Brendshme që ankuesit t'ia kompensoj të gjitha pagat nga dita e shkarkimit me datë 14.10.2022, deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Ndërsa, duke marr parasysh se mandati i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, përfundon me datë 22.01.2023, gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar të vendimit të Këshillit, dhe meqenëse në rrethanat e rastit konkret janë konsumuar kërkesat sipas nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 42 paragrafi 7 të njëjtit ligj, konstaton detyrimin e njësisë përgjegjëse, gjegjësisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për emërimin e ankuesit në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë profesionale.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.1017/2022

Avdyl Bektashi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autoriz
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Arkivit të KPMSHCK- së;